MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN PETRELË, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Petrelë, Tiranë, me objekt: **“**“Mbi zbatimin e ligjit buxhetit të shtetit dhe atij lokal, gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit vendor dhe përdorimi efektiv i fondeve buxhetore sipas planit dhe llojit. Prokurimet e fondeve publike për mallra dhe shërbime. Procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve dhe lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit etj”. “ dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.35 , datë 15.03.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 386/6, datë 15.03.2012, dërguar **z. Ylli Kupi,** Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Për Kryetarin e Komunës:

1. Të bëhet zgjidhja e menjëhershme e kontratës së qirasë datë 01.06.2010 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjorë tokë inproduktive”, një sipërfaqe prej 10,000 m^2 e lidhur midis qiradhënësit Komunës Petrelë dhe qiramarrësit shoqëria [redacted], për moszbatim të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” të ndryshuar dhe të UKM nr. 2, datë 14.05.2009 “Për kriteret e konkurrimit dhe procedurë e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor”, nga mangësitë në përmbajtjen e aktit, nga pamjaftueshmëria e kompetencave të autoritetit të Komunës Petrelë, nga mosrespektimi i formës së procedurës etj.

Menjëherë

2. Nga ana e Kryetarit të Komunës, të kërkohet që të regjistrohen në regjistrat e ZVRPP, të gjithë pasuritë e miratuar me VKM si: pyjet, kullotat dhe livadhet etj, në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, në përputhje me ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar.

Vazhdimisht

3. Nga ana e Kryetarit të Komunës, në të gjitha rastet, kur Këshilli i Komunës vendos “Për dhënien në përdorim të tokës pyll” kur janë të regjistruara në regjistrat e ZVRPP Tiranë në emër të Komunës Petrelë, të nxjerr shpallje për procedurën e konkurrimit publik ku të jetë përcaktuar, parcela, sipërfaqja në m^2, vendi, data dhe ora.

Vazhdimisht

4. Kryetari i Komunës në zbatim të nenit 40, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar, ti paraqes Këshillit të Komunës, kërkesën për nisjen e procesit për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit, i cili të përmbaj:

a. Studimin që përcakton faktet dhe analizon problemet për instrumentin e paraqitur për shqyrtim dhe përmbledhjen e vërejtjeve apo propozimeve të palëve të interesuara.

b. Kufijtë e territorit, për të cilin hartohet instrumenti vendor i planifikimit.

c. Planin e veprimeve për sigurimin, sipas rastit, të bashkërendimit horizontal e vertikal dhe përfshirjen e palëve të interesuara.

Menjëherë

II. Për Këshillin e Komunës:

1. Në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar Këshilli i Komunës, të miratoj projektin e instrumentit vendor të planifikimit ose ta rikthej për ripunim atë me vërejtjet përkatëse, në rastet kur vlerëson se:

- nuk janë kryer bashkërendimi, këshillimi dhe dëgjimi publik ose nuk janë respektuar procedurat e tjera të detyrueshme të planifikimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- projekti ka mospërputhje me instrumentet e planifikimit ose me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

2. Këshilli i Komunës të miratoj rregullat e kontrollit të zhvillimit, sipas rëndësisë e natyrës së çështjeve, në përputhje me rregulloret uniforme të kontrollit të zhvillimit dhe rregulloret kombëtare të kontrollit të zhvillimit.

Menjëherë

III. Për Autoritetin Përgjegjës të Planifikimit

1. Autoriteti përgjegjës i planifikimit, të mos pranojë kërkesa për leje zhvillimi, pa paraqitur më parë Pëlqimin Mjedisor të Agjencisë Rajonale të Mjedisit të Qarkut Tiranë, në mbështetje të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar.

Vazhdimisht

2. Autoriteti përgjegjës i planifikimit, të mos pranojë kërkesa për leje zhvillimi nga subjekte të ndryshëm brenda dhe përreth zonës së Kalasë së Petrelës, pa pasur më parë leje nga Instituti i Monumenteve të Kulturës pranë Ministrisë së TKRS.

Vazhdimisht

3. Autoriteti përgjegjës i planifikimit të pranojë dhe të shqyrtojë kërkesat për leje përdorimi vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit.

Vazhdimisht

4. Autoriteti përgjegjës i planifikimit të mos pranojë dhe të mos shqyrtojë kërkesat për leje përdorimi kur ka mos zbatim të projektit të miratuar në lejen e ndërtimit, në zbatim të pikës "ç" të nenit 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe UKM nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit".

Vazhdimisht

5. Autoriteti përgjegjës i planifikimit, të mos pranoj dhe të mos shqyrtoj kërkesa për leje përdorimi për subjektet ndërtuese, pa pasur më parë një vërtetim nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Komunës që të vërtetojë shlyerjen e gjobave të vendosura nga INU i Komunës.

Në çdo rast

6. Për të gjithë rastet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit në lidhje me konstatimet e bëra në fushën e urbanistikës, nuk mund të rekomandojmë masa organizative, për faktin se ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën" i ndryshuar, është shfuqizuar me hyrjen në fuqi me datë 30.09.20011 i ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar.

IV. Për Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik pranë Komunës.

1. Për punimet e kryera pa leje ose në shkelje të kushteve të lejes, sipas ligjit, autoritetet e inspektimit, krahas dënimit për kundërvajtjet e konstatuara, ti kërkojnë kundërvajtësit të paraqesë pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit, një kërkesë për pajisjen me leje të punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare.

Vazhdimisht

2. Në çdo rast kundërvajtësi së bashku me kërkesën për zhvillim, të paraqes dokumentin që vërteton pagimin e gjobës së vënë, brenda 30 ditëve nga data e vendimit për kundërvajtjen administrative, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar.

Vazhdimisht

3. Kryeinspektori INU, Komunës Petrelë, në të gjitha rastet kur është mbajtur procesverbal konstatim kundërvajtje për objektet pa leje ndërtimi dhe shtesa kati pa leje ndërtimi mbi objektet ekzistuese, duhet vazhduar proceduara ligjore për pezullim punimi, për vendim gjobe dhe për vendim prishje objekti.

Vazhdimisht

IV. Për Zyrën Tatim Taksa.

1. Nga Zyra e Tatim Taksave të merren të gjitha masat për ndjekjen dhe arkëtimin e tarifave dhe taksave vendore, gjithashtu të bëhet një parashikim sa më real duke shfrytëzuar mundësitë reale të territorit të komunës.

Vazhdimisht

2. Të merren masa nga Zyra e Tatim Taksave që të ardhurat nga biznesi i vogël dhe biznesi i madh të planifikohen pa rezerva dhe të realizohen sipas miratimit të Këshillit të Komunës.

Vazhdimisht

3. Të merren masa nga Komuna Petrelë, Zyra e Tatim Taksave që në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" të bëhet inventarizimi i dosjeve të subjekteve të biznesit të vogël dhe të biznesit të madh.

Vazhdimisht

4. Të marren masa nga Komuna Petrelë, Sektori i Tatim Taksave që në dosjet e biznesit të vogël dhe të biznesit të madh të plotësohet deklarata e parashikimit të qarkullimit

vjetor si dhe të ndahet në këste detyrimi vjetor dhe të njoftohen zyrtarisht tatimpaguesit para datës 1 mars të çdo viti ushtrimorë.

Vazhdimisht

5. Të merren të gjitha masat që dokumentet e zbatimit të punimeve për vitet 2010, 2011 e në vazhdim të jenë të rregullta, si: librezat e masave të plotësohen me skica për të argumentuar volumet, projektet të jenë të plota dhe të azhurnuara me punimet e kryera nga sipërmarrësi me qëllim që të pasqyrohen punët e kryera në fakt dhe të vendosen në dosjet e objekteve, si dhe të arkivohen dosjet teknike të objekteve të përfunduara e të marra në dorëzim.

Vazhdimisht

6. Të merren të gjitha masat, që projektet e punimeve, rikonstruksioneve si të rrugëve dhe të objekteve social kulturore, të bëhen me përgjegjësi nga projektuesi, që detyrat e projektimit të jenë të sakta dhe me kërkesat e investitorit, me qëllim që ato të reflektohen në projekt dhe të dorëzohen bashkë për të parë se si janë realizuar kërkesat e saj në projekt.

Vazhdimisht

7. Të merren masa, që të kontrollohen periodikisht zbatimi i kontratave për punë publike, për çdo ndryshim në volume apo zëra të punës, të kërkuar nga mbikëqyrësi e sipërmarrësi i objektit, përpara paraqitjes për miratim tek kryetari i autoritetit kontraktor, të kërkohet edhe miratimi i projektuesit.

Vazhdimisht

V. Për Zyrën e Financës dhe Njësinë e prokurimit

1. Gjatë përdorimit të fondeve publike, në asnjë rast të mos lejojë copëzimin e tyre me qëllim shmangien e procedurave të prokurimit, në zbatim të pikës 2 të nenit 28 "Metodikat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Vazhdimisht

2. Njësia e prokurimit, të mos vendosë kritere diskriminuese me qëllim shmangien e Operatorëve ekonomikë në tenderë, por të veprojë në zbatim të nenit 1, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar si dhe shtojcës 18, të udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3, datë 04.02.2009 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Dokumentacionin Standard për procedurën e hapur për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe kryerjen e punëve publike" dhe nenin 1 pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Vazhdimisht

3. Njësia e prokurimit, të mos nisë procedurën e prokurimit të tenderëve, në kushtet e mungesës së fondeve, në zbatim të pikës 1/ç, të Kreu-t të V-Zhvillimi i procedurave, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar.

Vazhdimisht

4. Njësia e prokurimit në asnjë rast të mos nisë procedurën e prokurimit të tenderëve, jashtë afateve ligjorë të përcaktuar, në zbatim të pikës pikën 3/ç "Buletini i prokurimeve

publike”, të Kreu i I - Organizimi i prokurimeve, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

Vazhdimisht

VI. Për Këshillin e Komunës Petrelë.

1. Të hartohet rregullorja e funksionimit mbi bazën e organikës së miratuar mbështetur në nenin 32, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohen në rrugë ligjore dëmet ekonomike të shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën **614,050 lekë**, pasi nga kontrolli i dokumentacionit teknik të zbatimit i administruar në dosjen teknike, u konstatuan diferenca në zëra dhe volume pune të pakryera në fakt.
Operatorët ekonomikë janë:
1. [redacted] sh.p.k. për vlerën **279,300 lekë** për objektin “Sistemi asfaltimi rrugës Fikas Qeha Shytaj Hekal”.
2. [redacted] për vlerën **52,750 lekë** për objektin “Rikonstruksioni i shkolles 9 vjeçare të fshatit Daias”.
3. [redacted] për vlerën **282,000 lekë** për objektin “Rikonstruksioni i ujësjellësit Petrelë”.

C. MASA ADMINISTRATIVE

C. 1. Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16, Komuna të kërkojë nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë saj, të gjobisë mbikëqyrësin e punimeve të ndërtimit si më poshtë, për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik.
Veprimet e kryera prej tyre bien në kundërshtim me nenin 4, paragrafi parë, Kreu II-të, neni 7 paragrafi tretë, neni 8 paragrafi dytë, neni 9 paragrafi tretë shkronja “c” dhe neni 12 paragrafi parë pikat 1,2,3 dhe 4 të Kreut III-të, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Mbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime; me pikën 4 paragrafi tretë, pika 5/c dhe 15 paragrafi i dytë, pika 17 dhe 19 të Kreut I-rë, pikat 3/a, 3/b dhe 3/c të Kreut II-të të UKM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikat 3/4, 7, 7/1 dhe 7/3 Kreu I-rë dhe pikat 2, 2/1 dhe 4 të Kreut III-të të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.
[redacted], në cilësinë e mbikëqyrësit, në objektin “Sistemi asfaltimi rrugës Fikas Qeha Shytaj, Hekal”, “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare të fshatit Daias” dhe “Rikonstruksioni i ujësjellësit, Petrelë”, gjobë në masën 100,000 lekë, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 279,300 lekë, 52,750 lekë dhe 282,000 lekë pasi:
Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën 279,300 lekë, 52,750 lekë dhe 282,000 lekë.

C. 2. Në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.20072007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu X, të kërkohet nga APP që për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike në vitin 2010, 2011, të marrë masa për personat e mëposhtëm:

[redacted] në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

[redacted] në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

[redacted] në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për shkak se në tenderët me objekt:

a. "Sistemim-asfaltim i rrugës fundi i asfaltit ekzistues fshati Fikas... shtesë kontrate" për segmentin shtesë Komuna Petrelë, me vlerë 9,919,170 lekë.

b.Ujësjellësi Qeha i fituar nga operatori ekonomik [redacted]. me vlerë të kontratës 6,963,049 lekë.

c. Sistemim asfaltim rruge Qeha, Mangull-Gurë, i fituar nga operatori ekonomik [redacted] me vlerë të kontratës 63,691,841 lekë dhe

d. Rikonstruksioni i ujësjellësit Petrelë", i fituar nga operatori ekonomik [redacted]. dhe [redacted] me vlerë 40,633,689 lekë, kanë zhvilluar procedurat në mungesë të fondeve në kundërshtim me pikën 1/ç, Njësia e prokurimit dhe urdhri i prokurimit, të Kreu-t të V Zhvillimi i procedurave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, e cila përcakton se: " kur sigurohen fondet dhe ka nevojë për punë... titullari i AK ... nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë objektin e prokurimit, fondin e venë në dispozicion.".

Për tenderin "Rikonstruksioni i ujësjellësit Petrelë", urdhri i prokurimit i lëshuar në datë 29.10.2008, është në kundërshtim me pikën 3/ç Buletini i prokurimeve publike, të Kreu-t të I-rë **"**Organizimi i prokurimeve", të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, e cila përcakton se: Çdo Autoritet prokurues të përfundojë procedurat për ... ndërtime, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit brenda datës 31 tetor të çdo viti. Brenda këtij afati përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse... Botimi i çdo lloj vendimi tej këtij afati bëhet vetëm me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

[redacted], me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Financës në cilësinë e kryetares së komisionit për blerjet me vlera të vogla, për shkak se ka lejuar ndarjen e fondeve për blerjet me vlera të vogla gjatë vitit 2010 në 23 raste me vlerë 4,640,950 lekë dhe gjatë vitit 2011 në 11 raste me vlerë 3,616,206 lekë, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 28 "Metodikat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, e cila përcakton se ... nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

C. <u>MASA DISIPLINORE</u>

Mbështetur në nenet 37, 141, 153 pika 1,2 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Zgjidhje e menjëhershme e kontratës" për:

[redacted] me detyrë përgjegjës i Zyrës Taksave Vendore, për mos plotësimin dhe evidentimin e dosjeve të tatimpaguesve në regjistra, si dhe për mos evidentimin e listave të subjekteve që nuk kanë likuiduar detyrimet në momentin e marrjes në dorëzim nga ana e Zyrës së Tatim Taksave pranë Komunës.

[redacted] me detyrë kryeinspektor në INU të Komunës për mos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, në zbatim të nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit" dhe në pikën 2,3,4,5 të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 "Për inspektimin e procedurave të kontrollit mbi territorin nga INUK dhe INUV".
[redacted] me detyrë ish-përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës në cilësinë e Sekretarit të KRRT-së, nuk rekomandojmë marrjen e masave disiplinore për shkak se ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me Komunën Petrelë dhe për pasojë masa disiplinore ndaj tij quhet e ezauruar.

C. KALLËZIM PENAL

Neni 258 "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike" i Kodit Penal, ndaj 3 personave të mëposhtëm:
[redacted] në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO).
[redacted] në cilësinë e anëtares së KVO
[redacted] në cilësinë e ish anëtarit të KVO.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Seit Spahia, fatmir Zilja, Skënder Hajdari dhe Tatjana Shurbi. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT